

**Bashkimi Evropian
Instrumenti për ndihmën Para -Anëtarësimit
për Zhvillimin Rural – IPARD II**

NJOFTIM

MBI SHTYRJEN E AFATIT

THIRRJA E DYTË PËR APLIKIME Nr. 02/2019 nga Programi IPARD II

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dhe Autoriteti Menaxhues në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural shpall shtyrjen e afatit për Dorëzimin e Aplikimeve, në kuadër të Programit IPARD II, nga Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA) për Zhvillimin Rural (IPARD) me qëllim zhvillimin e Sektorit Agro-Ushqimor për thirrjen e dytë, si më poshtë:

1. Shtyrjen e afatit për aplikime për Thirrjen e Dytë nga Programi IPARD II deri në datën 15 Janar 2020.
2. Vendimi për shtyrjen e afatit publikohet në:
Në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në të paktën tre gazeta që shpërndahen në të gjitha rajonet e Shqipërisë, në faqen e internetit të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
3. Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen **vetëm në zyrat qendrore të AZHBR-së** në zarfe të mbyllura me titullin *Thirrje për Dorëzimin e Aplikimeve*, së bashku me titullin e masës, emrin e plotë dhe adresën e aplikantit dhe me shënimin **“Të mos hapet përpara dorëzimit”**, deri në datën **15 Janar 2020, sipas orarit zyrtar 08:00 -16:30**.

Aplikimet duhet të dorëzohen si më poshtë:

- Nëpërmjet dërgesës postare rekomandë, ose
- Dorazi (duke përfshirë shërbimet korriere) direkt në Autoritetin Kontraktues në këmbim të një mandati dorëzimi me firmë dhe datë nga:

<Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr.56
Tiranë, Shqipëri>

Aplikimet e dërguara nëpërmjet çdo mënyre tjetër (p.sh. me faks apo e-mail) apo të dërguara në adresa të tjera do të refuzohen.

Çdo aplikim i mbërritur në zyrat qendrore AZHBR pas datës 15 Janar 2020 do të refuzohet.